

Thirrje për Aplikim për Organizatat Jo-Fitimprurëse



Vodafone Albania Foundation

Informacion i përgjithshëm: Fondacioni Vodafone Albania (FVA) është një **organizatë jo-fitimprurëse** që vepron në Shqipëri. Ky Fondacion dedikon fonde vjetore për organizata të shoqërisë civile për zbatimin e **projekteve me impakte sociale** pasi kanë marrë aprovimin përkatës. Fondet e FVA mundësohen mbi baza vjetore përkatësisht nga donatorët Vodafone Albania Sh.A. dhe Fondacioni Vodafone (FV) në Mbretërinë e Bashkuar. Fushat prioritare ku FVA jep mbështetjen me anë të këtyre fondeve përfshijnë: **Shëndetësinë, Arsimimin, kushtet Social-Ekonomike të Komuniteteve në Nevojë** si dhe **Mjedisin**. Projekt propozimet priten të kenë impakt të drejtëpërdrejtë në jetën e komuniteteve në nevojë. Që prej fillimit të aktivitetit të Fondacionit prej më shumë se dy vitesh, janë financuar një total prej 55 grantesh dhe 16 projektesh të tjera që i perkasin programit "Bota e Ndryshimit".

Aplikimet: Fondacioni Vodafone Albania njofton raundin e 7-të të "**Thirrjes për Aplikime**" për fondet e vitit financiar 2011-2012. Nëse jeni një organizatë jo-fitimprurëse dhe punoni në një nga fushat që janë në fokus të misionit të FVA, atëherë mund të jeni të **përshtatshëm për aplikim**. Vetëm OJF-të, të cilave u miratohet projekt propozimi nga Bordi i Fondacionit do të mund të nënshkruajnë një marrëveshje me Fondacionin për zbatimin e projektit. Informacioni përkatës për përgatitjen e një **Projekt-propozimi** mund ta gjeni në faqen e internetit të Vodafone Albania, www.vodafone.al, në seksionin Fondacioni Vodafone Albania..

Periodha e Aplikimit: 3 Nëntor – 6 Dhjetor 2010

Projekt propozimi duhet të përmbajë planin buxhetor (i shprehur në Lekë), planin e aktiviteteve të projektit dhe planin e komunikimit sipas udhëzimeve specifike që do ti gjeni në faqen e rekomanduar të internetit ose duke komunikuar me zyrën e FVA.

Kohëzgjatja e projektit: maksimalisht 1 (një) vit. Projektet e miratuara duhet të planifikohen për të filluar jo më herët se data **31 Mars 2011**

Dokumentet e kërkuara:

1) Projekt propozimi (sipas udhëzimeve të zyrës së FVA/faques së internetit); **2)** Forma e Aplikimit;
3) Dokumentet e identifikimit të organizatës, përkatësisht: kopje të vendimit të gjykatës, aktin e themeimit, statutin, NIPT, deklaratën e Bankës ku përfshihet llogaria bankare në Lekë dhe emrat e dy personave të autorizuar për firmë, apo dokumenta të tjera shtesë të kërkuara nga FVA) vërtetimin nga Drejtoria e Tatim-Taksave që dëshmon se organizata nuk ka detyrime të pashlyera, si dhe një letër të paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i organizatës mbi vërtetësinë e dokumentave të dorëzuara prej organizatës.

Për më shumë informacion, ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të sipër-përmendur ose kontaktoni me zyrën e Fondacionit Vodafone Albania nga ora 9:00-17:00 nga e hena në të premte:

Bulevardi " Bajram Curri", European Trade Centre, Kati i 10 Tiranë

Tel. (04) 2283268/7; Fax. (04) 2283333 – Email: foundation.al@vodafone.com / www.vodafone.al